

## KAPITULLI 79

# ZINKU DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

### Shënim

1. Në këtë Kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë bashkangjitur tyre:

(a) Shufra dhe shkopi:

Produkte të petëzuara, të stampuara, të tërhequra apo të farkëtuara, jo në spirale, të cilat kanë një seksion kryq solid uniform gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndësh baraz brinjor apo shumëkëndësh të rregullt konveks (përfshirë "rathët e dystuar" dhe "drejtkëndëshat e modifikuar", prej të cilëve dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tillë të cilët kanë një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar") i kalon një të dhjetat e gjerësisë. Shprehja gjithashtu përfshin edhe produktet e derdhura apo të shkrira, të formave dhe dimensioneve të njëjta, të cilët vazhdimisht janë punuar pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbukurime apo heqje të bigorit), me kusht që si rrjedhim ato nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(b) Profile:

Produkte të petëzuara, të stampuara, të tërhequra, të farkëtuara apo të formuara, në spirale ose jo, të një seksioni kryq uniform gjatë gjithë gjatësisë së tyre, të cilët nuk përputhen me ndonjë nga përcaktimet e shufrave, shkopi, telave, pllakave, fletave, shiritave, krisafëve, tubave apo tubacioneve. Shprehja gjithashtu përfshin edhe produktet e derdhura apo të shkrira, të formave të njëjta, të cilët janë përpunuar vazhdimisht pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbukurim apo heqje të bigorit), me kusht që si rrjedhim ato nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(c) Tela:

Produkte të petëzuara, të stampuara apo të tërhequra, në spirale, të cilët kanë një seksion kryq uniform solid gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndëshit baraz brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks (përfshirë "rathët e dystuar" apo "drejtkëndëshat e modifikuar", prej të cilëve dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tillë me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë edhe "drejtkëndëshin e modifikuar") i kalon një të dhjetat e gjerësisë.

(d) Pllaka, fleta, shirita dhe krisafe:

Produkte me sipërfaqe të sheshtë (përveçse produktet e papërpunuara të kreut 7901), në spirale ose jo, të një seksioni kryq solid drejtkëndësh (përveçse katrorë) me ose pa qoshe të rrumbullakosura (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar" prej të cilit dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele) të një trashësie uniforme, të cilët janë:

- të formës drejtkëndëshe (përfshirë katrorin) me një trashësi jo më tepër sesa një të dhjetat e gjerësisë,
- të formës ndryshe nga drejtkëndëshe apo katrorë, të çdo përmase, me kusht që ato nuk marrin si rrjedhim karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

Kreu 7905 përfshin, ndër të tjera, pllakat, fletat, shiritat dhe krisafet me struktura (psh, brazda, flanaxha, katrorë, çarje, butona, romba) dhe për të tilla produkte që janë perforuara, korruguara, lustruara apo veshura, me kusht që si rrjedhim ato nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(e) Tuba dhe tubacione:

Produkte të zgavruara, në spirale ose jo, të cilët kanë një seksion kryq uniform vetëm me një zgavër bashkangjitur gjatë gjithë gjatësisë së tyre të formës rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndësh baras brinjor apo shumëkëndësh i rregullt konveks, dhe të cilët kanë një trashësi uniforme të mureve. Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë edhe katrorin), trekëndësh baras brinjor apo shumëkëndësh të rregullt konveks, të cilët mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre, do të konsiderohen gjithashtu si tuba dhe tubacione me kusht që seksioni kryq i brendshëm dhe i jashtëm janë baras qendrore dhe kanë të njëjtën formë dhe orientim. Tubat dhe tubacionet e seksioneve kryq të sipërpërmendura mund të jenë të llustrosura, të veshura, të përkulura, të filetuara, të shpuara, të ngushtuara, të zgjeruara, të dhëna formë koni apo të përshtatura me flaxha, bokulla apo unaza.

**Shënim i nën krerëve**

1. Në këtë Kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë bashkangjitur tyre:

(a) Zink, jo i lidhur

Metal që përmban ndaj peshës të paktën 97,5 % zink.

(b) Lidhje zinku

Substance metalike në të cilët zinku predominon ndaj peshës mbi çdo nga elementet e tjerë, me kusht që përmbajtja totale ndaj peshës të elementeve të tillë të tjerë të kalojë 2,5%.

(c) Pluhur zinku

Pluhur i fituar nga kondesimi i avujve të zinkut, përbërë nga copa sferike të cilët janë më të imët sesa pudër zinku. Të paktën 80% ndaj peshës e këtyre copave kalojnë nëpërmjet njësitë me diametër 63 µm (mikron). Ai duhet të përmbajë të paktën 85 % ndaj peshës zink metalik.

Kodi i mallrave	Përshkrimi	Njësitë plotësuese	Masa të politikës tregtare		Norma te detyrimit (%)	Norma preferenciale të detyrimit (%)	TVSH (%)	Norma të akcizës
			Importi	Eksporti				
7901	Zink i papërpunuar:							
	- Zink, jo i lidhur:							
7901 1100 00	-- Që përmban ndaj peshës 99,99 % apo më shumë zink	-	-	-	0	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7901 12	-- Që përmban ndaj peshës me pak sesa 99,99 % zink:							
7901 1210 00	--- Që përmbajnë ndaj peshës 99,95 % apo më shumë por më pak se 99,99 % zink	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7901 1230 00	--- Që përmbajnë ndaj peshës 98,5 % apo më shumë por më pak se 99,95 % zink	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7901 1290 00	--- Që përmbajnë ndaj peshës 97,5 % apo më shumë por më pak se 98,5 % zink	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7901 2000 00	- Lidhje zinku	-	-	-	0	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7902 0000 00	Mbetje dhe kthime zinku	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7903	Pluhura, pudër dhe fetëza zinku:							
7903 1000 00	- Pluhur zinku	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7903 9000 00	- Të tjera	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7904 0000 00	Shufra, shkopinj, profile dhe tela zinku	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7905 0000 00	Pllaka, fleta, shirita dhe krisaf zinku	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 8	18	-
[7906]								
7907 0000 00	Artikuj të tjerë prej zinku	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 8	18	-